



KUVENDI I KOMUNËS KOMITETI PËR KOMUNITETE

Procesverbal nga mbledhja e XV-të (pesëmbëdhjetë - mandati VII), e Komitetit për Komunitete, e mbajtur më 03 nëntor 2023

Mbledhja u mbajt në sallën e mbledhjeve të Kuvendit, ndërtesa e Komunës, dhe filloi në orën 10;10.

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi z.Xhafer Ademi Kryesues i Komitetit për Komunitete.

Fillimisht u vërtetua se në mbledhje ishin të pranishëm anëtarët e këtij Komiteti dhe atë: znj.Qëndresë Hajrizi, z.Florent Hasani, z.Arbnor Fazliu, znj.Shkurte Sejdiu, znj.Sevdije Mustafa, z.Selver Rama, z.Demokrat Hodolli, znj.Fikmete Qurkolli.

Me këtë u konstatua se ekziston kuorumi për punë.

Në mbledhje të pranishëm ishin z.Liman Zeqiri shef i Zyrës Komunale për Komunitete dhe Kthim-ZKKK, Blerim Vllasa nga Drejtoria e Arsimit në Komunën e Podujevës, përfaqësues të KFOR.

Rendi i ditës

z.Xhafer Ademi, Kryesues i Komitetit, e hapi mbledhjen, përshëndeti të pranishmit dhe i'u dëshiroj punë të mbarë, theksoi, thirrjen dhe materialin për këtë mbledhje besoj e keni marrë me kohë të gjithë, andaj në vazhdim lexoj pikat e rendit të ditës dhe njëkohësisht pyes nëse ndokush dëshiron fjalën rreth rendit të ditës, nëse jo e hedh në votim, por paraprakisht jeni në dijeni që pas dhënies së dorëheqjes nga ish anëtarja e këtij komitete znj.Naile Ahmet, janë zhvilluar proceduar përkatëse dhe është sjellë e nominuara nga komuniteti jo shumicë znj.Fikmete Qurkolli emri i të cilës është votuar edhe në Kuvendin e Komunës, prandaj sot është prezentë fillon mandatin e saj në këtë Komitet për Komunitete për çka i dëshirojmë mirëseardhje dhe punë të mbarë.

Njëzëri nga të pranishmit miratohet rendi i ditës sipas thirrjes së kësaj mbledhje.

1. Procesverbali nga mbledhja e Komitetit për Komunitete e mbajtur më 19.09.2023

z.Xhafer Ademi, Kryesues i Komitetit, urdhëroni nëse ndokush dëshiron fjalën rreth këtij procesverbali, nëse jo atëherë e hedh në votim.

Njëzëri, pa vërejtje apo plotësim ndryshime miratohet procesverbali i Komitetit për Komunitete nga mbledhja e mbajtur më 19 shtator 2023

2. Informatë e Drejtorisë së Arsimit rreth vizitës në SHFMU “DR. Ibrahim Rugova” dhe SHFMU “Naim Frashëri” në koordinim me Zyrën Komunale për Komunitete dhe Kthim si dhe anëtarët e Komitetit për Komunitete, lidhur me vijueshmërinë mësimore për nxënësit e komuniteteve jo shumicë dhe parandalimin në proceset mësimore.

Kryesuesi i Komitetit, theksoi, për këtë pikë të rendit të ditës prezent kemi zyrtarin nga Drejtoria e Arsimit i cili sigurisht se do të na paraqet informata përkatëse.

z.Blerim Vllasa, zyrtar në Drejtorinë e Arsimit – DKA në Podujevë, e paraqiti informatën në fjalë, theksoi, në kudër të detyrave dhe përgjegjësi që kemi si zyrtar arsimor si dhe detyrave tjera që na jepen, ne në Drejtorinë e Arsimit e kemi të themeluar dhe funksional Ekipin për parandalim dhe reagim ndaj braktisjes dhe mos regjistrimit e nxënësve në arsimin e obliguar, Ekip e cila trajton rastet e mos regjistrimit dhe braktisjes së arsimit të obliguar nga nxënësit, do të thotë intervenojmë si Ekip. Gjithashtu kemi bashkëpunim edhe me ZKKK si dhe përfaqësuesit e Komuniteteve e që në kuadër të këtij bashkëpunimi kemi pas vizita në shkollat në të cilat ka numër më të madh të nxënësve të komuniteteve siç janë shkollat “Dr. Ibrahim Rugova” dhe “Naim Frashëri”.

Po ashtu për informimin e juaj secila shkollë ka ekipet e veta për trajtimin dhe monitorimin e rasteve të braktisjes së shkollimit, mirëpo kur të shterren të gjitha mundësitë brenda shkollës pastaj sipas ligjit janë të obliguar që rastet t’i referojnë në DKA e që mandej ne si Ekip Komunal i trajtojmë ato raste.

Në fillim të këtij viti shkollor 2023/2024, nga shkollat janë raportuar se kanë qenë gjithsejtë 6 raste të nxënësve të cilët nuk kan vijuar mësimin apo e kanë ndërprerë mësimin për shkaqe të ndryshme, me të pranuar këto informata ne si Ekip komunal jemi mbledhur dhe kemi pas fillimisht takime me përfaqësuesit e atyre lagjeve, kemi vizituar familjet e atyre nxënësve ku jemi njoftuar për së afërmi për arsyet përse ata nxënës nuk e vijnë mësimin, mirëpo pas këtyre takimeve, nga drejtorët e shkollave jemi njoftuar se ata nxënës janë trajnuar dhe kanë filluar ta ndjekin mësimin, pra njëra prej arsyeve ka qenë se ata nxënës nuk janë pajisur me tekste shkollore dhe të gjëra tjera të ngjashme, por siç e ceka sipas informatave që kemi prej drejtorëve të shkollave ata nxënës janë rikthyer dhe po vijnë shkollimin.

Nga familjet e komunitetit jo shumicë që banojnë në rr.”Ali Ajeti” nxënësit e të cilave vijnë mësimin në shkollën “Naim Frashëri” kemi informata nga drejtori i shkollës se disa nxënës nuk janë duke e vijuar mësimin. Ne së bashku me z.Liman Zeqirin shef i ZKKK si dhe anëtar i Ekipes komunale kemi vizituar këtë shkollë ku këtë çështje e kemi diskutuar me drejtorin e shkollës dhe i kemi dhënë udhëzimet e duhura që ekipi brenda shkollës t’i shterrë të gjitha mundësitë ligjore që ka dhe të angazhohet që ata nxënës të kthehen në procesin mësimor.

Po ashtu ne si Ekip në kuadër të DKA-së është në fazën e hartimit të planit komunal kundër braktisjes së shkollimit, ku jemi duke punuar një ekip prej 5 anëtarëve dhe shpresojmë që deri në fund të këtij viti një plan të tillë ta kemi për miratim në Kuvendin e Komunës, plan sipas të cilit për çdo nxënës i Komunës së Podujevës të krijohen mundësi të barabarta për shkollim.

Kryesuesi i Komitetit, theksoi, falënderoj parafolësin z.Blerim Vllasa për informatat e dhëna dhe më pëlqeu kjo që e potencoj. Ne vërtetë që kemi qenë në vizita nxënësve të komuniteteve jo shumicë dhe kemi parë përsëafërmi jetën e tyre që kanë dhe sfidat me të cilat ballafaqohen, një pjesë e tyre nuk i kanë prindërit e shkolluar dhe kishin shumë probleme. Disa prej tyre nuk janë të regjistruar në shkolla për shkak të moshës së tyre që janë më të rritur e që nuk janë regjistruar me kohë dhe tani kjo paraqet probleme, prandaj jemi munduar të bëjmë vetëdijësimin e tyre dhe të prindërve kështu që neve tani na e ka lehtësuar punën Qendra për arsim dhe aftësim shtesë që është

funksionalizuar tash së fundmi në shkollën “Dr. Ibrahim Rugova” e që besoj shumë se tani e tutje nxënësit do të jenë shumë më mirë në proceset e mësim nxënies sepse kemi provoja të tilla nga e kaluara. Po ashtu besoj se në të ardhmen nuk do të ketë braktisje të shkollimit sepse vetëdijesimi sa më shumë vie në shprehje.

Në shkollën “Naim Frashëri” unë kam pasë kontakte të drejtpërdrejta me zëvendës drejtoreshën shkollës e cila ka ardh në lagjen ku jetoj unë dhe më ka kontaktuar për disa nxënës të komuniteteve jo shumicë të cilët nuk e vijnë mësimin, kështu që kemi organizuar takim me prindërit e tyre aty për aty dhe i kemi marrë mendimet e tyre përse ata nuk e vijnë mësimin. Disa prej tyre i kemi kthyer në proces mësimor e që është bërë një punë e mirë, por që kemi edhe dy raste të braktisjes së mësimin që janë Elhame Lahu dhe Elmedina Ajeti, e që arsyet për Elhamen janë për shkaqe të disiplinës sepse nuk është vajzë e disiplinuar dhe e rehatshme në shkollë kështu që prindi i saj e ka paraparë që ajo duhet ta ndërpresë shkollimin dhe e ka ndërprerë, ndërsa Elmedina Ajeti e ka gjyshen e sëmurë me kancer dhe në gjendje jo të mirë andaj siç na kanë thënë nuk ka kush rrinë me gjyshen edhe pse janë munduar ta bëjnë një zëvendësim por nuk kanë munduar, nuk kanë gjet askënd, kështu që edhe kjo e ka braktisur definitivisht shkollimin edhe pse jemi munduar shumë ta zgjidhim këtë çështje dhe t’ia mundësojmë asaj nxënëseje vazhdimin e shkollimit, mirëpo prapëseprapë familja e saj e ka vendos që ajo të qëndroj në shtëpi dhe të kujdeset për gjyshen e saj. Pra për momentin kemi këto dy raste të braktisjes së shkollimit, kemi e dhe një rast të klasës së parë e cila është regjistruar ka vijuar mësimin por nuk mund të qëndroj në klasë pa prind kështu që paraqet probleme dhe telashe pastaj në klasë por që me mendimin e kujdestares së klasës, drejtoreshës së shkollës dhe prindit të asaj nxënëseje janë marr vesh që ta lënë për vitin e ardhshëm të vijoj mësimin deri sa ajo të rritet dhe të zhvillohet paska ngase ishte e pamundur të vazhdohej mësimi në klasë duke qarë dhe bërtitur ajo nxënëse, prandaj nuk ka hyrë në pjesën e nxënësve që ka braktisur shkollimin sepse kjo vazhdon në vitin e ardhshëm, mirëpo këto janë raste të cilat duhet të monitorohen. Gjithashtu vlen të ceket se në këtë shkollë mungon Qendra për arsim dhe aftësim shtesë dhe sigurisht se do kemi paksa telashe sepse në të kaluarën Qendra në fjalë ka qenë në monitorim të të gjithë nxënësve të cilët e kanë vijuar mësimin por që pastaj braktisin atë, pra për një kohë të gjatë kemi pasë përfaqësues të OJQ “Ballakan Sun Flowers” dhe OJQ “VORAE” që kanë monitoruar këtë çështje por që tash ai monitorim është ndërprerë dhe ka mbete që monitorimi të bëhet vetëm prej qendrës së cekur dhe prej neve si përfaqësues të komuniteteve jo shumicë. T’ju them të drejtën unë jam në kontakte të vazhdueshme me drejtor/ështa të shkollave dhe mësimdhënës dhe vazhdimisht kujdesem dhe i vizitoj prindërit e atyre nxënësve që bëjnë shumë mungesa si dhe për çështje tjera të ndryshme.

Falënderoj shumë Komunën e Podujevës që tash së fundmi ka bërë një hap shumë të madh duke ri funksionalizuar Qendrën e arsimit dhe aftësimin shtesë, e që besoj se tani e tutje do të ketë përmirësime të mëdha.

z.Arbnor Fazliu, theksoi, falënderoj përfaqësuesin e DKA z.Blerim Vllasa dhe përfaqësuesin e ZKKK z.Liman Zeqiri për informata e dhëna dhe rreth vizitave që kanë bërë.

po ashtu deshta të njoftohemi rreth rastit që në mbledhjen e kaluar ka treguar anëtarja kolege e në këtë Komitet, konkretisht për atë fëmijën që ka bërë 11 vjet dhe ende nuk është regjistruar në klasë të parë.

Kryesuesi i Komitetit, theksoi, ne kemi qenë vizitë tek ajo familje dhe kemi biseduar me prindin e tij, ai djalë nuk është regjistruar sepse ka arritur moshën 12 vjeçare dhe tani si mund të regjistrohet në klasë të parë, kështu që me kohë nuk është regjistruar dhe tani ashtu siç mendon ndokush që të regjistrohet në klasë të parë, kjo nuk mund të bëhet sepse ka rregulla. Pavarësisht kësaj unë kam propozuar që djalë fillimisht të shkon në Qendër të arsimit shtesë të paktën që të mos mbetet pa

mësuar shkrim lexim deri sa të bëhet ndonjë zgjidhje e që ndoshta mund të jetë fillimisht regjistrimi e pastaj notimi për vitet e humbura, e mandej nëse lejohet të fillon mësimin sipas viteve që ka, përndryshe atë nuk kemi ku ta regjistrojmë tani.

znj.Shkurte Sejdiu, theksoi, në lagjen ku jetoj unë janë 4 nxënës që e kanë braktisur përfundimisht shkollimin (Rifat Halili, Naim Halili, Nafije Halili dh Ardita Sejdiu) me të cilët kam biseduar për shkaqet dhe rrethanat e braktisjes.

Kryesuesi i Komitetit, pyetje për parafolësen, theksoi, a keni biseduar me zotëri Ademin për rastin përkatës

znj.Shkurte Sejdiu, përgjigje Kryesuesit, theksoi, po kam biseduar dhe përgjigja e tij është se nuk po dëshirojnë të vijnë shkollimin, kjo ishte përgjigja.

z.Blerim Vllasa, përfaqësues i DKA, theksoi, ne kemi qenë në vizitë tek ata fëmijë dhe në ato familje bashkërisht me Kryesuesin e Komitetit dhe kemi biseduar, ankesat ishin më të ndryshme, nuk kanë libra, jo andej jo këndej. Jemi dakorduar që të ndërmarrim veprime në bashkëpunim me ekipin e DKA-së, ekipin e shkollës dhe ne të tjerët që të bëjmë përpjekje. Pra 2-3 dite unë kam kontaktuar me drejtorin e shkollës për këtë çështje dhe jemi në përpjekje që ata nxënës t'i kthehem mësimi, madje ato dy vajzat janë kthyer në shkollim por që jemi duke punuar edhe me rastet tjera që të kthehen në shkollë dhe të vijnë mësimin, pra kjo është informata zyrtare e drejtorit të shkollës përkatëse.

z.Liman Zeqiri, shef i ZKKK, theksoi, fillimisht falënderoj zyrtarin e DKA-së për informatat e dhëna dhe që ishin të sakta dhe domethënëse duke e konsideruar si obligim ligjor e moral ngase jemi përfaqësues të institucioneve dhe ekipeve të ndryshme përkatëse.

Për rastet e cekura kemi qenë të informuar dhe vazhdimisht kemi bërë përpjekje për kthimin e fëmijëve në shkolla sepse është edhe obligim ligjor kjo çështje. Unë e kuptoj se vërtetë është një gjendje shumë e rëndë socio-ekonomike dhe këtë e bazë edhe nga vizitat e vazhdueshme që kam nëpër familje. Në vizitën e fundit që isha në familjen Behluli që është komunitet jo shumicë, kam marrë shënime dhe informata të nevojshme dhe të njëjtat i kam dorëzuar në Drejtorinë e Shëndetësisë dhe në atë të Arsimit, pra bëhet fjalë për 4 nxënës të asaj familjeje që e kanë ndërprerë shkollimin, dhe normale që arsyeja ka qenë për shkaqe që ata prindër nuk kanë ditë të aplikojnë në rimbursimin e teksteve shkollore, pastaj është dashtë të kenë edhe gjiro llogari, dhe në këtë aspekt kemi bërë përpjekje bashkërisht me Drejtorinë e cekura që të gjejmë zgjidhje madje duke bërë përpjekje të bëjmë një kontakt edhe Ministrinë e Arsimit në mënyrë që të mundësohet sigurimi i teksteve për ato nxënës, krejt kjo që të mos jenë tekstet shkak i braktisjes së shkollimit ngase pastaj ne dalim keq si institucione. E them këtë sepse ajo familje është në gjendje jo të mirë ekonomike, mirëpo ne si Ekip që jemi themeluar kemi për obligim që për të gjithë nxënësit të ndërmarrim veprime dhe të kujdesemi që të mos ketë braktisje të shkollimit si dhe për kthimin e atyre që eventualisht e kanë braktisë për shkaqe të ndryshme.

Riaktivizimi i Qendrës për arsim shtesë në shkollën “Dr. Ibrahim Rugova” si dhe qendrat tjera që do të riaktivizohen sigurisht se do të ketë ndikim, do të rritet volumi i mësimi, nxitja dhe vullneti për mësimnxënie sa më të madhe të nxënësve, me theks atyre të komuniteteve jo shumicë për të cilët jemi duke diskutuar sot, shembull siç ishte ajo pengesa e fëmijët 12 vjeçar, pra të gjejmë format dhe mënyrat që të pakën të gjejmë një rehabilitim të tyre me shkrim lexim.

Unë jam shumë i bindur që do të aktivizohen edhe Qendrat tjera nëpër shkolla tjera të qytetit që është një ndihmesë shumë e madhe për komunitetet jo shumicë.

Kryesuesi i Komitetit, theksoi, sa për informimin e juaj, konkursi për bursa për komunitetin jo shumicë është shpallë për shkolla të mesme dhe për fakultete, kështu që lus anëtarët e këtij Komiteti që janë nga radhët e komunitetit jo shumicë të bëjnë informimin e nxënësve dhe studentëve që të aplikojnë, edhe pse unë personalisht kam shkuar nëpër shkolla dhe i kam njoftuar drejtorët e shkollave që t'i njoftojnë nxënësit e shkollave të mesme dhe t'ju japin dokumentet e nevojshme me kohë sepse afati është shumë i shkurtër. Problem që mund ta quaj mbetet çështja e aplikimit sepse është online dhe disa prej tyre po hasin në vështirësi dhe nuk dinë të aplikojnë, pra drejtorët kanë shprehë gatishmëri që t'ju dalin në ndihmë, madje duke i'u shkuar edhe në klasa dhe duke i'u shpërndarë vërtetimet përkatëse dhe duke i'u asistuar në dokumente dhe çështje tjera të nevojshme për të mund që dokumentet të dërgohen me kohë, prandaj i falënderoj shumë drejtorët e shkollave të cilët kanë shprehë një mirëkuptim të madh në lidhje me bursat e nxënësve të komuniteteve jo shumicë.

z.Liman Zeqiri, shef i ZKKK, theksoi, kam raste që kanë ardh edhe ZKKK për të plotësuar dokumentacionin e nevojshëm për aplikim për bursa, mirëpo ne paksa e kemi të vështirë në disa raste sepse nuk mund të bëhet identifikimi i një nxënësi se cilit komunitet i takon ngase dokumentet që i posedojmë ne aty shkruhet Kosovar, pavarësisht kush është dhe nga cili komunitet është, qoftë në letërnjoftim, qoftë në certifikatë qoftë në dokumente tjera, megjithatë ne kemi bërë përpjekje në këtë aspekt duke parë edhe nevojat e tyre që t'iu ndihmohet atyre në këtë aspekt.

Edhe me Planin e veprimit komunal për avancimin e të drejtave të komuniteteve, do të thotë përveç integritimit ne duhet të punojmë tani edhe për avancimin e të drejtave të tyre, kemi paraparë që t'iu jepet edhe një dokument shtesë nga ZKKK me të cilin qartësohet se NN personi është nga radhët e NN komunitetit jo shumicë, çështje të cilën unë me përkushtim e bëj çdoherë.

Është mirë që bëhen thirrje të tilla dhe që jepen informata të tilla, e që ne ZKKK jemi të gatshëm të veprojmë dhe të punojmë si dhe t'i pajisim me dokumentacionet e nevojshme nxënësit e komuniteteve jo shumicë në këtë rast.

Kryesuesi i Komitetit, theksoi, falënderoj parafolësin z.Liman Zeqiri i cili gjithherë na ka përkrahë, madje në raste të caktuara edhe pas orarit të punës duke punuar për dokumente të cilat janë të nevojshme për nxënësit e komuniteteve jo shumicë.

Urdhëroni nëse ndokush dëshiron fjalën, nëse jo atëherë e konsideroj të përfunduar këtë pikë të rendit të ditës.

3. Informatë e Zyrës Komunale për Komunitete dhe Kthim rreth Memorandunit të Mirëkuptimit me Organizatën Ndërkombëtare për Migrim IOM.

z.Liman Zeqiri, shef i ZKKK, paraqiti informatën në fjalë, ndër të tjera theksoi, theksoi, në bazë të një Memorandumi të lidhur mes Komunës së Podujevës dhe organizatës ndërkombëtare për Migrim IOM, për mbështetje me fondet e BE dhe me implementim të IOM, organizatë e cila ka vite që na ka ndihmuar shumë neve, dhe unë do t'i potencoj në pika të shkurtra disa prej tyre për çka jemi mirënjohës ndaj kësaj organizate ne si institucione komunale. Pra duke falënderuar IOM-in e cila çdo herë ka qenë e përkushtuar dhe na ka ndihmuar, janë shumë shkolla që kanë përfituar në emër të komunitetit jo shumicë por që janë projekte dhe mjete që përfshihen dhe shfrytëzohen edhe nga komuniteti shumicë sepse ka kabinete dhe mjete tjera të ndryshme që kanë pasë një vlerë jashtëzakonisht të madhe deri në 15,000.00€ dhe që janë shumë funksionale për nxënësit, siç janë

shkollat “Dr.Ibrahim Rugova”, “Shaban Shala”, “Naim Frashëri”, pastaj shkollat në fshatrat Sfeçël Batllavë dhe Orllan të cilat kanë përfituar projekte ku përfshihen të gjitha pajisjet që i’u kanë nevojitur për çështje të arsimit.

Pra këtë vit janë pajisur 2 shkolla (në Orllan dhe në Sfeçël). Pra Shkolla “Zahir Pajaziti” në fshatin Orllan ka përfituar pajisjet në vlerë rreth 11,800.00€, kurse shkolla “Ali Ajeti” në fshatin Sfeçël ka përfituar mjete në vlerë rreth 15,000.00€, mirëpo çdo herë duke participuar edhe Komuna e cila vazhdimisht ka qenë e gatshme dhe në afat kohor ka kryer obligimet e veta financiare prej 30% të vlerës së projektit.

Normale që ne i kemi vizituar shkollat bashkërisht edhe me IOM-in dhe është konstatuar se duhet të ndihmohen. Përveç ndihmës në shkolla unë e përgëzoj shumë këtë organizatë për shumë projekte në funksion të stabilizimit socio – ekonomik të komunitetit jo shumicë me të cilin bashkëjetojmë ne në Kosovë, dhe në kuadër të këtyre ndihmave edhe pse bilanci është paksa më i vogël i atyre bizneseve që vetë gjerojnë të hyra apo siç mund ta quajmë vetë punësim me kapacitetet e veta janë ndihmuar me një vlerë jo aq të madhe në këtë vit që ka qenë 10% e që janë ndihmuar 2 familje sipas programeve të hapura publike, konkurrimit dhe vizitave që ju janë bërë atyre bizneseve që dëshirojnë ta rritin biznesin apo ta mbajnë gjallë biznesin e tyre e që mund të kenë paksa më shumë përparësi në bazë të rregullave të organizatës së cekur. Pra behet fjalë për biznese të ndryshme siç janë axhustator, mjeshtër të veturave, dhe mjete tjera që dinë dhe punojnë ku shembull në lagjen ku jetojnë komuniteti jo shumicë në rr.”Xhafer Meta” është ndihmuar Hajriz Bajrami me 4290.00€ e që 390.00€ ka participuar ai vet, pastaj kemi ndihmën në vlerë 5000.00€ Samet Ahmeti në lagjen gjen ku jetojnë komuniteti jo shumicë në rr.”Ali Ajeti”.

Në total për disa vite kemi 9 familjarë që nga kjo Organizatë janë ndihmuar me 33,760.00€ dhe për këtë jemi duke e marrë si pikë referencë, Komuna është duke na ndihmuar me të gjitha kapacitetet e veta, po ashtu Organizata IOM është në ndihmë të vazhdueshme për perona të komuniteteve jo shumicë në mënyrë që të mos mbeten barrë me asistencë sociale ngase ne jemi në dijeni se një numër i madh i komuniteteve jo shumicë janë me asistencë sociale por në anën tjetër janë të aftë dhe të zotët të punojnë, andaj ata që dëshirojnë të rrisin kapacitetet e tyre të ndihmohen dhe të bëjnë vetë punësim dhe ta rrisin veprimtarinë e tyre, prandaj e kam parë shumë të arsyeshme që t’ju jap një informatë lidhur me këto çështje dhe t’ju informoj sado pak që çdo herë jemi në mundim e sipër së bashku me këtë Organizatë për stabilizimin në jetë të komuniteteve jo shumicë.

Kryesues i Komitetit, theksoi, falënderoj sërish z.Liman Zeqirin për këto informata dhe për bashkëpunim të vazhdueshëm me komunitetin jo shumicë.

Është e vërtetë se kjo Organizata IOM na ka ndihmuar bukur mirë komunitetin jo shumicë.

Vlen të theksohet që rreth 3 viteve e kemi ndërtuar edhe fushën e sportit me këtë Organizatë ku i kemi heqë fëmijët nga rruga dhe tani bashkërisht edhe me fëmijët e komunitetit shumicë lozin bashkë dhe shfrytëzojnë atë fushë të sportit në rr.”Ali Ajeti”.

Urdhëroni nëse ndokush ka diçka për të thënë, nëse jo e përfundoj këtë pikë të rendit të ditës.

4. Të ndryshme

znj.Sevdije Mustafa, theksoi, kërkoj që mundësisht mbledhjet e Komitetit të mbahen për çdo muaj dhe atë në fillim të muajit sepse po ndodh që mbledhjet të mbahen në periudha të ndryshme brenda muajve, dhe ka raste kur në ndonjë muaj nuk është mbajtur mbledhje.

z.Liman Zeqiri, shef i ZKKK, theksoi, parafolësja ka shumë të drejtë e që edhe ne mendojmë që mbledhjet të mbahen në fillim të muajve, mundësisht para datës 10 kur edhe është afati i fundit për dërgimin e kompensimeve, mirëpo kësaj radhe ka qenë paksa një problematikë tjetër sepse është dashtë të presim hyrjen në fuqi të vendimit për emërimin e anëtares së re të këtij Komiteti që është Fikmete Qurkollli në mënyrë që t'i mundësohet edhe asaj të merr pjesë në këtë mbledhje të planifikuar për muajin tetor, prandaj kjo ka qenë mirëpo unë mendoj se në bashkëpunim edhe me kryesuesin e Komitetit për Komunitete do të gjejmë hapësirës që të mbahet një mbledhje brenda këtij muaji në mënyrë që të mund të kompensohen mëditjet tuaja.

Zyrtari i Zyrës Ligjore, sqaroi se asnjë mbledhje nuk humb ashtu siç u cek nga parafolësja, çdo mbledhje që thirret edhe mbahet, mbledhjet thirren nga Kryesuesi i Kuvendit dhe rendi i ditës përgatitet po nga ai. Kjo mbledhje konsiderohet e muajit tetor ngase deri me datën 10 të çdo muaji ngase është si datë e fundit kur mund të dërgohen listat e kompensimeve mëditjeve, përndryshe ky Komitet ka një Plan të punës që e keni miratuar, aty janë të përcaktuara edhe datat e përafërta ku mbahen mbledhjet e që në plan është dashtë të përcaktohen dhe t'iu përmbaheni atij Plani pastaj.

Kryesues i Komitetit, theksoi, zyrën ligjore paksa e kemi ngarkuar por gjithsesi e falënderojmë sepse bëjnë punë të madhe, ndërsa sa i përket këtij takimi ashtu siç u cek na është dashtë të presim procedurat e hyrjes në fuqi të vendimit sipas të cilit është bërë zëvendësimi i një anëtareje të këtij Komiteti në mënyrë që të mund të merr pjesë edhe ajo në këtë mbledhje.

z.Blerim Vllasa, përfaqësues i DKA, theksoi, ne dje kemi pranuar një informatë prej Ministrisë së Arsimit që nxënësit të cilët nuk kanë mund të përfitojnë për tekste shkollore ose që nuk është arrite t'iu dalin mjetet financiare në llogaritë e tyre për arsye të ndryshme e që janë rreth 145 nxënës nga Komuna e Podujevës të cilëve për arsye të ndryshme nuk ju janë dalë mjetet financiare në llogaritë e tyre bankare. Ne në bashkëpunim me drejtorët e shkollave do t'ju dërgojmë listën e atyre nxënësve me të gjitha të dhënat e secilit aplikues. Pra Ministria i ka marr prej E-sistemit dhe na i ka dërguar neve nëpër Komuna se cilët nxënës kanë aplikuar mirëpo nuk i'u janë dalë paratë në llogari për arsye të ndryshme, andaj kërkoj edhe nga ju si përfaqësues të komuniteteve jo shumicë t'i informoni familjet e atyre nxënësve për këtë, përndryshe ne do të bëjmë presion edhe tek drejtorët e shkollave dhe tek kujdestarët e klasave që ata nxënës që nuk kanë arritur të përfitojnë nga thirrja e Ministrisë që të aplikojnë sërish por që edhe që të vijnë tek ne si Drejtori e Arsimit që të marrin sqarimet e duhura.

Kryesues i Komitetit, theksoi, Falënderoj parafolësin për këtë informatë shumë me vend sepse tek unë janë paraqitur një numër i familjeve të komunitetit jo shumicë që nuk i'u janë dalë paratë në llogaritë e tyre e që nuk kisha përgjigje sepse nuk kam qenë i informuar për shkaqet dhe arsyet, por që tani e mësova këtë për çka ju falënderoj serish sepse është informatë e mirë dhe do t'i njoftojmë ata nxënës që të ri aplikojnë.

z.Blerim Vllasa, theksoi, edhe njëherë çka do që nuk kuptojnë informatat i gjejnë tek drejtori i shkollës përkatëse i cili do t'iu tregoj konkretisht se ku kanë gabuar gjatë aplikimit sepse për secilin nxënës janë të dhënat ku tregohen gabimet apo shkaqet e mos realizimit të subvencionimit, informata të cilat mund t'i marrin edhe tek ne si Drejtorin e Arsimit.

Kryesues i Komitetit, theksoi, edhe njëherë ju falënderoj sepse kam pas shumë kërkesa dhe ankesa që nuk i'u janë dalë paratë sepse tekstet shkollore veç i kanë blerë por tani nuk ju janë

subvencionuar. Me rëndësi ishte që nxënësit nuk janë pa tekste shkollore kurse për subvencionimin e tyre sigurisht se do të gjendet zgjidhje.

znj.Qëndresë Hajrizi, theksoi, kam pyetje për zyrtarin e Drejtorisë së Arsimit, ka të bëjë rreth teksteve shkollore sepse disa nxënës nuk e kanë rritë moshën dhe platforma nuk po lejon të aplikohet për subvencionim të shumës për blerjen e teksteve shkollore, kështu që a ka ndonjë sqarim për këtë apo si qëndron kjo çështje.

z.Blerim Vllasa, theksoi, këto çështje janë duke u trajtuar nga kolegu z.Ardjan Emini, por sipas informatave që kam është një formular që do të plotësohet nga familjarët e nxënësit, pastaj ai formular i kthehet kolegut zotëri Emini i cili mandej i përcjellë të kompletuara tek zyrtarët përkatës të Ministrisë së Arsimit.

Pra DKA i kemi informatat vetëm për ata që kanë aplikuar, ndërsa jo për ata që uk kanë aplikuar fare siç ishte rasti i moshës së atyre nxënësve që nuk kanë pasë mundësi aplikimi sepse sa jam në dijeni për këtë çështje është një procedurë tjetër.

Meqë nuk kishte të lajmëruar për të marrë fjalën, Kryesuesi i Komitetit e konstatoj të përfunduar këtë mbledhje.

Mbledhja përfundoi në orën 10:30

**Procesverbalin e mbajti,
Enis Sheholli**

**Nr.Prot.01-106/01-0080300/23
Podujevë, 03 nëntor 2023**

**Kryesuesi i Komitetit
Xhafer Ademi**